



## **KOMUNIKATË**

### **24.02.2010**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbajti mbledhjen e 20-të të kryesuar nga Kryetarja znj. Nesrin Lushta. Në fillim të mbledhjes, KQZ miratoi rendin e ditës dhe aprovoi raportet 06 dhe 08/ 2010 të mbledhjeve të kaluara.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike e informoi KQZ-në se më 27 janar, iniciativa politike nga komuniteti serb e quajtur "Demokratska Alternativa" (DA), të cilën e kryeson z. Dragan Stojkovic, ka dorëzuar aplikacionin e kërkesës për regjistrimin si parti politike. Zyra pas pranimit të aplikacionit, e ka kontrolluar dhe verifikuar tërë dokumentacionin e nevojshëm sipas kushteve të parapara për regjistrim. Pas periudhës prej dhjetë (10) ditësh të verifikimit nga Zyra, si dhe rishikimit publik të dokumentacionit prej datës 11 shkurt deri më 17 shkurt 2010, nuk është pranuar asnjë ankesë apo vërejtje përkitazi me kërkesën për regjistrim si parti politike të kësaj iniciative politike.

ZRPP, i rekomandoi KQZ-së që ta regjistroj këtë iniciativë politike, e cila do të hyjë në regjistër si partia politike e 47-të me radhë, e regjistruar në Kosovë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi këtë rekomandim për regjistrimin e këtij subjekti të ri politik me emrin Alternativa Demokratike (AD).

Gjithashtu, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike i rekomandoi KQZ-së që të marrë vendim për shqiptimin e tarifave administrative për subjektet politike të cilat i kanë dorëzuar raportet e Deklarimit Financiar të fushatës me vonesë në afatin e ndëshkueshëm brenda 15 ditëve. Këto subjekte janë: Samostalna Liberalna Stranka (SLS), Gradjanska Inicijativa za Promene (GIZAP), Grupa Gradjana Kosovski – Bozhur, Zajdno za Siriničku Zhupu (ZSZH), Narodna Stranka Kosova, Gani Krasniqi, Predrag Stanojković dhe Balli Kombëtar (BK). KQZ miratoi këto tarifa të cilat janë në shumën prej 50, deri në 500 euro.

Në vazhdim të mbledhjes, Zyra Ligjore i rekomandoi KQZ-së të bëjë zëvendësimin e Këshilltarëve të Kuvendeve Komunale të Klinës ( 1 këshilltar) dhe të Graçanicës ( 1 këshilltar ). KQZ i miratoi këto ndryshime të këshilltarëve të këtyre dy komunave.

Lidhur me organizimin e procesit të rivotimit në komunën e Gjilanit, Komisioni Komunal Zgjedhorë (KKZ) i kësaj komune ka kërkuar që të sigurohet një zgjidhje më efektive për prodhimin e disnjektivëve ( bexhave) që do të përdoren në ditën e rivotimit. Ferid Shabani, kryetar i KKZ-së, ka paraqitur para KQZ-së propozimet për mënyrën dhe formën e përgatitjes së këtyre disnjektivëve. KQZ në parim ka përkrahur propozimin e KKZ-së së Gjilanit, por ka kërkuar që të gjitha anët teknike – ligjore të realizohen përmes Sekretariatit të KQZ-së.